



KONTRATE – THEMELIMI
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“PRELLA” SH.P.K.

Personat qe firmosin me poshte :

Z. DHJONIS PREMTI, I biri I Yllos, me shtetesi shqiptare, I datelindjes 1951, lindur ne Nivice dhe banues në Sarandë, me zotesi juridike per te vepruar.

Z.ELEKTRA PREMTI, e bija e Vasos, me shtetesi shqiptare, e datelindjes 1951 lindur dhe banuese ne Tirane, me zotesi juridike per te vepruar.

Z. ALTIN PREMTI, i biri i Stillos, me shtetesi shqiptare, I datelindjes 1973, lindur dhe banues ne Sarande, me zotesi juridike per te vepruar.

Z. LEONARD LLAMBRI, i biri i Kocos, me shtetesi shqiptare, i datelindjes 1974, lindur ne Nivice dhe banues ne Sarande, me zotesi juridike per te vepruar.

Kane hartuar me poshte si vijon kontraten e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, te cilet jane marre vesh ta themelojne midis tyre.

Emertimi I shoqerise eshte “PRELLA” SH.P.K.

Objekti i shoqerise eshte : Ushtrim te aktivitetit privat ne prodhimin e artikujve ushqimore, bujqesore dhe blegtorale, te materialeve inerte, tregtim me shumice e pakice te artikujve industriale, bujqesore, blegtorale ,ushqimore, materialeve te ndertimit, prodhimeve inerte, makina, makineri dhe pjese kembimi per to, import – eksport ne teresi, konsulence ne fushen ekonomike, gjeologjike, ndertim objektesh te ndryshme.

Selia e shoqerise do te jete ne Krekez te fshatit Nivice – Bubar te rrethit Sarande, por me kalimin e kohes selia e shoqerise mund te ndryshoje si brenda ashtu edhe jashte rrethit me pelqimin e ortakeve.

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 Leke. Ky kapital perbehet nga kontribuetet e meposhteme :



Z. DHIONIS	PREMTI	kontribon me shumen prej 25.000 leke .
Z. ELEKTRA	PREMTI	kontribon me shumen prej 25.000 leke.
Z. ALTIN	PREMTI	kontribon me shumen prej 25.000 leke
Z. LEONARD	LLAMBRI	kontribon me shumen prej 25.000 leke

Kapitali themeltar eshte I ndare ne 100 pjese, plotesisht te shlyeshme me vlere 1000 leke secila, te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne numrin e serise 100.

Ne baze te kontributeve te mesiperme :

Z. DHIONIS PREMTI, merr 25 pjese te kapitalit themeltar te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne numrin e serise 25 per kontributin e tij ne para.

Z. ELEKTRA PREMTI , merr 25 pjese te kapitalit themeltar te renditura sipas numrit te serise nga 26 deri ne numrin e serise 50 per kontributin e tij ne para.

Z. ALTIN PREMTI, merr 25 pjese te kapitalit themeltar te renditura sipas numrit te serise nga 51 deri ne numrin e serise 75 per kontributin e tij ne para.

Z. LEONARD LLAMBRI, merr 25 pjese te kapitalit themeltar te renditura sipas numrit te serise nga 76 deri ne numrin e serise 100 per kontributin e tij ne para.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar, shlyer plotesisht dhe jane shperndare ndermjet ortakeve si me lart.

Shuma e mesiperme eshte mbledhur nga Z. ALTIN PREMTI , dhe eshte depozituar ne Dhomen e Notereve Sarande.

Shoqeria do te administrohet nga një administrator . Administratori i pare i emeruar do të jetë Z. Altin Premti me nje mandat 2 - vjecar dhe me te drejte rizgjedhjeje.


Z. ALTIN PREMTI i jepen te gjitha kompetencat te cilat ai do ti perdor per te kryer te gjitha formalitetet e themelimit te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Ai gjithashtu është i autorizuar te veprojë ne emer te shoqerise qe do krijohet deri ne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar ne gjykatën e Tiranës, vecanerisht ai do të jetë i pajisur me mandat per te kryer akte dhe per te marre angazhime ne emer te shoqerise te cilat I kalojne shoqerise qe nga momenti I regjistrimit.

Administratori është i ngarkuar te kryej akte dhe te marre angazhime qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise dhe kompetencat e tij.

Pasi te behet regjistrimi I shoqerise keto akte I nenshtrohen miratimit te bashkesise se ortakeve jo me vone se nga data e mbledhjes se Asamblese qe shqyrton dhe vendos per





Hogarite e e vitit te pare financiar. Ky miratim ben automatikisht kalimin e ketyre akteve dhe angazhimeve ne ngarkim te shoqerise.

Kjo kontrate perpilohet ne kater ekzemplare, ne Sarande, me daten 19.11.2001 ne kater ekzemplare, ne gjuhen shqipe duke pasur te gjitha fuqi te barabarte ligjore. Nje kopje dorezohet ne gjykatën e rrethit Tirane ku behet dhe regjistrimi i shoqerise , kopja tjeter lihet ne zyren noteriale, kopja tjeter lihet ne zyren noteriale , kopja e trete dorezohet ne degen e tatime – taksave dhe kopja e katert mbahet nga vete ortakët e shoqerise

ORTAKET

DHIONIS PREMTI



ELEKTRA PREMTI



ALTIN PREMTI



LEONARD LLAMBRI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA DELVINE

Nr. 690 Rep
Nr. 590 Kol

VERTETIM

Sot me daten 19.11.2001 u paraqiten personalisht para meje noterit Shkelqim Haxhi, ne zyren e noterise Delvine, shtetasit shqiptare Dhionis Premti, Elektra Premti, Altin Premti dhe Leonard Llambri, ortakë te themelimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "PRELLA" SH.P.K. me seli ne Krekez te fshatit Nivice – Bubar te rrethit Sarande, madhorë dhe te afte dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet e tyre personale, te cilet me deklaruan se sa me siper eshte shkruar me vullnetin e tyre te lire dhe e nenshkruan para meje. Une mbasi e gjeta ne rregull i vertetoj sipas ligjit.

NOTERI

SHKELQIM HAXHI





STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“PRELLA” SH.P.K.

Personat qe firmosin si me poshte:

Z. DHJONIS PREMTI, I biri I Yllos, me shtetesi shqiptare, I datelindjes 1951, lindur ne Nivice dhe banues ne Sarandë, me zotesi juridike per te vepruar.

Z.ELEKTRA PREMTI, e bija e Vasos, me shtetesi shqiptare, e datelindjes 1951 lindur dhe banuese ne Tirane, me zotesi juridike per te vepruar.

Z. ALTIN PREMTI, i biri i Stillos, me shtetesi shqiptare, I datelindjes 1973, lindur dhe banues ne Sarande, me zotesi juridike per te vepruar.

Z. LEONARD LLAMBRI, i biri i Kocos, me shtetesi shqiptare, i datelindjes 1974, lindur ne Nivice dhe banues ne Sarande, me zotesi juridike per te vepruar.

Kane hartuar si me poshte vijon statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar te cilen jane marre vesh ta themelojne midis tyre.

KREU I

FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI,SELIA, KOHEZGJATJA

NENI I

FORMA

Ndermjet firmuesve te aktit themeltar eshte hartuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi si dhe me dispozitat e ketij statuti

4



NENI II

EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi I shoqerise eshte "PRELLA" SH.P.K.

NENI 3

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i shoqerise eshte : Ushtrim te aktivitetit privat ne prodhimin e artikujve ushqimore, bujqesore dhe blegtorale, te materialeve inerte, tregtim me shumice e pakice te artikujve industriale, bujqesore, blegtorale ,ushqimore, materialeve te ndertimit, prodhimeve inerte, makina, makineri dhe pjese kembimi per to, import – eksport ne teresi, konsulence ne fushen ekonomike, gjeologjike, ndertim objektesh te ndryshme.

NENI 4

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise do te jete fillimisht ne Krekez te fshatit Nivice – Bubar te rrethit Sarande.

Transferimi I selise se shoqerise ne nje adrese tjeter behet me miratim e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar.

NENI 5

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise eshte parashikuar per nje periudhe prej 30 vjetesh duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar. Kjo periudhe mund te zgjatet tej ketij afati ose te shkurtohet kur shoqeria priset para kohe.

KREU III

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar eshte 100.000 Leke

Ai eshte I ndare ne 100 pjese te barabarta me vlere 1000 Leke secila, te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100 te shlyera plotesisht. Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te reja, ortakët kane te drejten e perparësisë ne nenshkrim propocionalisht me shumen e pjeseve te tyre. Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj. Zvogelimi I kapitalit vendoset nga Asamblea e ortakëve me shumicën e ortakëve te pranishem ose te perfaqesuar qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar. Zvogelimi I kapitalit prek te gjithë ortakët ne te njeten mase.

NENI 7

KONTRIBUTET

Z. DHIONIS	PREMTI	kontribon me shumen prej 25.000 leke .
Z. ELEKTRA	PREMTI	kontribon me shumen prej 25.000 leke.
Z. ALTIN	PREMTI	kontribon me shumen prej 25.000 leke
Z. LEONARD	LLAMBRI	kontribon me shumen prej 25.000 leke

NENI 8

PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Ne baze te kontributeve te lartpermendura :

Z. DHIONIS PREMTI, merr 25 pjese te kapitalit themeltar te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne numrin e serise 25 per kontributin e tij ne para.

Z. ELEKTRA PREMTI , merr 25 pjese te kapitalit themeltar te renditura sipas numrit te serise nga 26 deri ne numrin e serise 50 per kontributin e tij ne para.

Z. ALTIN PREMTI, merr 25 pjese te kapitalit themeltar te renditura sipas numrit te serise nga 51 deri ne numrin e serise 75 per kontributin e tij ne para.

Z. LEONARD LLAMBRI, merr 25 pjese te kapitalit themeltar te renditura sipas numrit te serise nga 76 deri ne numrin e serise 100 per kontributin e tij ne para.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar nenshkruhen, shlyhen ploteisht dhe shpermdahen ndermjet ortakeve sipas ndarjes se mesiperme.

NENI 9

LENIA DHE TRANFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve ne rruge trashegimie ne rast ndarjeje pasurore ndermjet bashkeshorteve, ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen te treteve vetem me pelqimin e ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kushte me te favorshme se ato me te cilat u jane afruar ortakeve te tjere me pare.

KREU III

ORTAKET, ASAMBLEA E ORTAKEVE, ADMINISTRIMI, EKSPERTET KONTABEL


NENI 10

ORTAKET DHE ASAMBLEA E ORTAKEVE


Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saja deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjen e Asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Ne ushtrimin e se drejtes se tyre per te marre pjese ne vendimet kolektive cdo ortak ka te drejte te perfqesohet nga nje ortak tjetër ose nga nje person i zgjedhur prej tij.

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose disa ortak qe zoterojne 1/10 pjese te kapitalit themeltar, nga administratori, nga ekspertet kontabel te autorizuar ose nga likuiduesi.

Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e Asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme.



7



Asamblea e zakonshme vendos per ceshtje te tilla si : emerimi dhe shkarkimi I administratoreve, eksperteve kontabel, te autorizuar dhe likuiduesve, miratim te raporteve te administrimit, kontrollit, miratimin e llogarive vjetorew dhe ndarjen e fitimit.

Asamblea e jashtezakonshme vendos per ceshtje te tilla si : per ndryshimin e statutit, zvogelimin e kapitalit themeltar, transferimi I pjeseve te kapitalit themeltar tek te tjeret, zgjatja e afatit te veprimtarise se shoqerise apo likuidimi I saj, shnderrimi I shoqerise ne shoqeri te formave te tjera.

Asamblea e zakonshme ose e jashtezakonshme merr vendime te vlefshme ne rast se jane prezent ose te perfaqesuar nje numer ortakesh qe zoterojne mbi $\frac{1}{2}$ e pjeseve te kapitalit themeltar. Neqoftese mbledhja e pare e Asamblese se zakonshme nuk realizohet thirret mbledhja e dyte e cila mune te marre vendime te vlefshme, pavaresisht se sa pjese e kapitalit themeltar zoterojne ortaket e pranishme ose te perfaqesuar dhe vednimet merren me nje shumice votash te mvi $\frac{1}{2}$ te ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar.

Asamblea e jashtezakonshme kerkon kushte presence ose perfaqesimi te njeta me ato te Asamblese se zakonshme si ne mbledhjen e pare ashtu edhe ne mbledhjen e dyte, por ajo merr vendime me miratimin e ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar qe zoterojne $\frac{1}{4}$ e kapitalit.

NENI 11

ADMINISTRIMI

Shoqeria do të administrohet nga një administrator qe duhet te jetë person fizik dhe mund te jetë ortak ne shoqeri ose jo. Administratori mund te emerohet ose shkarkohet me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{1}{2}$ pjese te kapitalit themeltar. Emerimi I tyre behet prej nje kohe prej 2- vjetesh financiar me perjashtim te rasteve te dorcheqjes ose te shkarkimit te parakohshem.

Ne marredheniet me ortaket dhe te tretet administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise, me perjashtim te atyre rasteve dhe kompetencave qe ligji dhe ky statut ja japin shprehimisht ortakeve. Administratori ka pergjegjesi ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkeljet ligjore, qofte per shkeljet e statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij. Administratori ka te drejte te delegoje nje pjese te kompetencave te tij nje ortaku tjeter me ane te nje akti me shkrim.

Administratori i pare i zgjedhur është Altin Premti.



x





NENI 12

ESKPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

Kontrolli I shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel I autorizuar qe eshte emeruar per 3 - vite financiare, me mundesi rizgjedhjeje, nga ortaket qe perfaqesojne mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

Shkarkimi I ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njetat kondita si emerimi ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

NENI 13

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE


Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor . Perjashtim eshte viti I pare financiar qe do te perfundoje me 31 Dhjetor 2001.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht nga eksperti kontabel I autorizuar. miratohen nga Asamblea dhe me vendim te ortakeve. Miratimi I dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej gjashte muaj nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 14

DIVIDENTET

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe eviidentimit te ekzistences se fitimeve Asamblea e ortakeve percakton pjeset qe u takojne ortakeve ne formen e dividendeve mbi fitimin. Fitimi qe do te ndahet ndermjet ortakeve ne propocion me pjeset e kapitalit themeltar perbehet nga fitimi I vitit financiar te cilit I jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (5 % te fitimit te cdo viti derisa ky fond te arrije vleren 1/10 te kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetere I jane zbritur ose I jane shtuar respektivisht humbjet ose fitimet e mbetura nga vitet e meparshme.



KREU V

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 15

ZGJATJA E AFATIT

Me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 5 te ketij statuti zgjatja e tij mund te vendoset nga Asambleja me miratim te ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar.

NENI 16

PRISHJA


Shoqeria priset me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 5 te ketij statuti, me perjashtim te rasteve kur behet zgjatja e afatit sipas nenit 15 ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsye te parashikuara ne ligj. Shoqeria nuk priset kur njeri prej ortakeve falimenton, behet I paafte ose vdes.

NENI 17

LIKUIDIMI

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emeron nje ose disa likuidatore. Ata paraqesin para Asamblese raportin mbi gjednjen e aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit te shoqerise dhe mbi afatin e nevojshem te likuidimit te tyre.

Ne fund te procesit te likuidimit Asambleja vendos me miratim te ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuiduesit dhe mbi mbylljen e provetit te likuidimit. Pas pagimit te kreditorëve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkatese likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar.



DEJAVE

KREU VI

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 18

SHNDERRIMI I SHOQERISE

Shnderrimi I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri komandite ose kolektive mund te kryhet vetem me miratimin unanim te ortakeve, ndersa shnderrimi ne shoqeri anonime me miratimin e ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ pjese te kapitalit themeltar.

NENI 19

MOSMARREVESHJET

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit ndermjet ortakeve do ti paraqiten per zgjidhje gjykatave kompetente shqiptare.

NENI 20

Ky statut eshte hartuar ne kater ekzemplare ne Sarande, me daten 19.11.2001 ne gjuhen shqipe duke pasur te gjitha te njejten fuqi ligjore

Nje kopje dorezohet ne Gjykatën e rrethit Tirane, kopja tjeter lihet ne zyren noteriale, kopja e trete dorezohet ne degen e tatimeve dhe kopja e katert mbahet nga vete ortaket e shoqerise.

ORTAKET

DHIONIS PREMTI



ELEKTRA

PREMTI

ALTIN PREMTI



LEONARD

LLAMBRI

